
 Republika e Kosovës Republika Kosovo	<b>Zyra e Personelit          Kancelarija Osoblja</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.87/19	Data: 02.05.2019	

Menaxheri i Personelit në pajtim me dispozitat e ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149 dhe dispozitave të Rregullores nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, bëhet ky:

### NJOFTIM

Meqenëse nuk është arritur numri i ballancuar i kandidatëve sipas përfaqësimit etnik dhe gjinor, i përcaktuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, zgjatet afati edhe për 7 ditë të konkursit 05 Nr.210/2019 të dates 17.04.2019 i publikuar në të përditshmen "Bota Sot" të dates 17.04.2019 për plotësimin e vendeve të lira të punës:

- Zyrtar/e për Biblioteka 1, në Gjimnazin "Haxhi Zeka", në Istog;
- Zyrtar/e për Biblioteka 1, në SHMP "Mithat Frashëri", në Gjurakoc;
- Zyrtar/e për Biblioteka 1, në SHFMU "Trepça", në Banjë

Të gjitha kushtet dhe kriteret si dhe përshkrimi i punëve dhe detyrave, të cilat janë publikuar në konkursin e cekur janë të vlefshme.


" Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës ".

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr. 100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

Me kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të bëhet intervista nga komisioni, ndërsa për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Kandidatët të cilët kanë konkuruar sipas afatit të rregullt nuk janë të obliguar të konkurojnë sërish.

**Vërejtje:** Dokumentet e pa kompletuara, si dhe parashtrimi i kërkesave pas skadimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen



Menaxheri i Personelit,  
**Fatmir Bytyçi**